



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 26.05.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - PUNË
Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim godina njësisë administrative Ishëm (objekt i rindërtimit nga tërmeti)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punë ndërtimi - 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL: 41,804,175 (dyzet e një milion e tetëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

Në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr.117, datë 20.12.2024, të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar; për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentet standarde “Procedurë e përshpejtuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr.9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 datë 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumente.

Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

Argumentim:

Në zbatim të urdhrit të grupit të Specifikimeve Nr.131, datë 10/04/2026, e Nr.4833 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të bashkisë të vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.131, datë 10/04/2026, e Nr.4833 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr.162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 36.

PËRLLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.”

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e hartuar nga projektuesi “Infratech” shpk, të paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për

informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: “Ndërtim godina njësisë administrative Ishëm (objekt i rindërtimit nga tërmeti)”, rezultoi të jetë me vlerë: 41,804,175 (dyzet e një milion e tetëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj, sipas grafikut të punimeve. Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, e 83 të LPP-së, dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

3

2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 10*.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata "Ndërtim godina njësisë administrative Katund i Ri (objekt i rindertimit nga termeti)". Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve. Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata", të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përmes këtyre dispozitave garantohet që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit. Kërkesa është ligjërisht e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm*

financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së ndërtimit të godinës së njësisë administrative Katund i Ri, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tri vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit", si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

Ky kriter është ligjërisht i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve të ndërtimit të godinës së njësisë administrative Katund i Ri.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara te kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërisht i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.*

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/ët Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.169, datë 04/05/2026, e Nr.5865 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 2-fishi i fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi:

- a. NP – 1 A *Punime gjërmimi në tokë;*
- b. NP – 2 B *Ndërtime civile e industriale;*

Për punimet speciale të ndërtimit:

- a. NS – 1 A *Punime për prishjen e ndërtimeve;*
- b. NS – 2 A *Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;*
- c. NS – 4 A *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës*

teknikendërtues;

- d. NS – 12 A *Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimi*
- e. NS – 14 A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;*
- f. NS – 18 A *Punime topogjeodezike.*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përllogaritur të kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 A	Punime gjërmimi në tokë	"Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m ³ ,shkarkimi në auto" "Nërtim drenazhi,mbushje me zhavor prodhuar mak" Prishje struktura prej betoni "Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km" "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në sheshe, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet" "Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km"	A 0-20 <i>(deri 20 milion leke)</i>
NP-2 B	Punime civile dhe industriale	"Nenshtrese zhavori, t=20cm, poshtë shtresës së varfër" Mbushje me zhavorr pas mureve Mbushje me zhavorr pas mureve - xokoli "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese	A 21-50 <i>(deri 50 milion leke)</i>

		katrama" F V tub drenazhi Ø 150 mm Shtrese betoni C 12/15, T=15 cm Pllake themeli, b/a C 25/30 Kollona b/a C 25/30 h ~ 4m trare e arkitrare b/a C 25/30 Beton C25/30 për soleta dhe shkallë, h ~ 4m F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	
NS-1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve;	Prishje struktura prej betoni	A 0-20 <i>(deri 20 milion leke</i>
NS-2 A	Impiante hidro-sanitare,kuzhina,lavanderi dhe mirembajtja e tyre	FV lavaman porcelani importi me mishelator F.V WC allafrenga importi "F.V lavaman porcelani importi me mishelator per PAK" F.V WC allafrenga importi per PAK "F.V minivalvola nderprerese te paisjet hidrosanitare dhe boileret" F. Bojler elektrik, kapaciteti 80 lit.(komplet) F. Bojler elektrik, kapaciteti12 lit. Mates uji d = 50 mm FV Filter uji me rrjete DN 50 Pn 10 FV Valvol nderprerese DN50 mm FV Valvol moskthimi DN50 PN 6-10bar "F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=50mm, PN 16" "F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40 mm, PN 16" F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=32 PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=25 PN 16 F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20 PN 16 F.V. Pilete dyshemeje Ø 50 mm "F.V Tub shkarkimi PP me gota me gomina d 110 mm" "F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 75 mm" "F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe me gomina 50" FV Bryl 45° PP Ø50 FV Bryl 45° PP Ø 75 FV Bryl 45° PP Ø 110 F.V Reduksione PP Ø110-Ø75 F.V Reduksione PP Ø75Ø50 F.V Brage PP DN 50/50 FV Brage PP DN75/50	A 0-20 <i>(deri 20 milion leke</i>

		<p>FV Brage PP DN 110/50 FV Brage PP DN 110/75 FV Brage PP DN 110/110 FV Fasheta metalike me seksion rrethor dhe gomina elastomere per mberthimin e tubave Ø 100 F.V Pike kontrolli vertikal Ø 110mm F.V Kapuç ajrimi ne tarrace vertikal Ø 110mm FV Elemente mberthyes e fiksues" F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave" F.V Shtrese rere F.V Tubo korrogato Ø 200mm dhe Ø 160 "F.V Puseta betoni (100 x100) cm, me kapak me mbushje 80X80 cm, klasa C250" FV tub te zeze dhe rakorderi Ø1 1/2 " FV tub te zeze dhe rakorderi Ø 2 " FV tub te zeze dhe rakorderi Ø 2 1/2 " FV tub te zeze dhe rakorderi Ø 3 " "FV Pompe e mbrojtjes kunder zjarrit Pompe e elektrike dyshe - Fuqia e instaluar (2x2.5) kW, In =2x7.5 A, 3F-400V-50Hz - Prurja 14.4 m³ / h, Prevalenca 50 mkH2O - Presioni punes 6 bar, presioni max 16 bar Aksesoret: · Kolektori i dergimit 2½", me flanaxha PN 16 · Kolektori i thithjes 2½", me flanaxha PN 16 · Valvol nderprerese me farfalle, gize, PN16, DN 65 · Valvol moskthimi, me kllape, flanaxhe PN16, DN 65 · Xhunto elastike DN 65 · Suporte antivibrues · Manometer · Manovutometer Presotat per çdo pompe · Serbator me mebrane 20 lit , PN 10 · Kuader komande e kontrolli per çdo pompe -Pompa pilot . Fuqia 1.1 kw . Ryma 2.7 A. Kolektori ne thithje DN 65PN10. Dimensionet 1609 X1230 X1748 mm." "F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshem. Kasete brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyre te kuqe RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x610x190)mm, tub fleksibel 30 m, Aksesoret: saraqineske nderprerese 1½", lançe + zorre uji DN 45. Pjesa e perparme e mbyllur me</p>	
--	--	---	--

		<p>çeles."</p> <p>"FV Grup saraçineske me 1 gryke lidhje hidranti 2 1/2""dhe nje gryke 2"" për brigadat MNZ"</p> <p>"FV Fikse zjarri portabel me pluhur, 6kg, tipi 34A 233BC"</p> <p>FV Fikse zjarri portabel me CO2, 5kg, tipi 113B, per ambjentin e kabines elektrike ose pajisje elektrike" F.V Rezervuare uji vertikale - zingato per ujin sanitar dhe MNZ ME d= 1600 mm dhe H= 2660 mm me lidhje 1 1/2 ""</p> <p>F.V Pompa e sitemit te ujit sanitar me dy pompa me shume shkalle , me inverter me karakteristika teknike per Objektin Fuqia e instaluar 2 x 2.2 kw . Intensiteti i rymes 2x 3.5) A Lidhjet 2 1/2 PN 16, Tensioni i dhe ne 3F 400V, 50Hz Prurja 2 x 6.5 m³/ore . Prevalenca 35 m KH2O.</p>	
NS-4 A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to,rifiniture me materiale druri, plastic, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	<p>"Mur me tulla te lehtesuara t=20 cm deri 8 m, LL.P. M-25"</p> <p>"Mur me tulla me 4 vrima, t=10cm h~3m, LL.P. M-15"</p> <p>Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m dhe kolloncina F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mmShtrese me pllaka porcelanat importi Plintuse grez importi, h = 10 cm Veshje me pllaka (NH/S) Hidroizolim me dy shtresa mapej (NH/S) Shtrese me pllaka mermeri t=3cm "JANINA" F.V. Shtresë betoni C12/15 nivelimShtrese lluster çimento 1:2 F.V. Shtresë betoni C12/15 nivelim "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama" "Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 + fino" Boje hidroplastike importi cilesi e I-re Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine Ø 100 mm Veshje kornize me llamarineSuva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 Suva solete h > 4 m me drejtues, me krah Boje hidroplastike importi cilesi e IDyer te blinduara importi. V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara Dritare d/alumini dyfish xham.</p>	A 0-20 <i>(deri 20 milion leke</i>

		<p>F V vetrare d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>Shtrese me pllaka mermeri t=3cm "JANINA"</p> <p>"F.V. Konstrukione metalike të përbëra korimano shkallet"Hidroizolim me dy shtresa mapej</p> <p>Suvatim me grafiato h > 4 m</p> <p>Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m</p> <p>Boje hidroplastike importi cilesi e I-re</p>	
NS-12 A	Impiant teknologjik,termik dhe te kondicionimit	<p>F,V Konditioner inverter 18000 BTU</p> <p>F,V Konditioner inverter 12000 BTU</p>	<p>A 0-20</p> <p><i>(deri 20 milion leke</i></p>
NS-14 A	Impiante te brendshme elektrike,telefoni,radiotelefoni TV etj.	<p>F.V. Kanaline e birezuar Zn 200x75</p> <p>"V. Aksesore per kanaline Zn 200x75 (Kthesa, Kryqezime, Reduktore , Nderrim plani ,kapak aksesoresh etj sipas rastit)"</p> <p>V. Aksesore fiksimi me varje (kompletuar me 2cp prizhonier te filetuar M8 , 0.4m profil Zn55x18 ,6cp dado m8 , 6 cp rondele M8 , 2cp upa metalike M8)</p> <p>"F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø20mm me aksesore"</p> <p>"F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø25mm me aksesore"</p> <p>"F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø32mm me aksesore"</p> <p>"V. Kuti shperndarese PT5 154x128x70 brenda murit"</p> <p>"V. Kuti shperndarese C5 150x110x140 IP56 jashte murit"</p> <p>F.V. Separator metalik Zn 75x3000 per kanaline</p> <p>F.V. Tub korrugato dopioshtres D63</p> <p>V. Pusete plastike 30x30x30cm me kapakF.V.</p> <p>Kabell 4x50mm FG16OR16</p> <p>F.V. Kabell 5x2,5mm FTG18OM16</p> <p>F.V. Kabell 5x16mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 5x10mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 5x6mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 5x4mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 5x2,5mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 3x4mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 3x2.5mm FG16OM16</p> <p>F.V. Kabell 3x1.5mm FG16OM16</p> <p>F.V. percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2</p> <p>F.V. percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module e bardhe</p>	<p>A 0-20</p> <p><i>(deri 20 milion leke</i></p>

		<p>V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module e kuqe "V. Kuti per celesa e priza 3-module, suport , kapak & tapa per instalim brenda murit ." "V. Kuti per celesa e priza 4-module, suport , kapak & tapa per instalim brenda murit ." F.V. Celes 1P 10A F.V. Torrete dysHEMEJE per celsa priza 12M F.V. Torrete dysHEMEJE per celsa priza 16M F.V. Ndricues dekorativ per lulishte 10W, IP65 F.V. Ndricues rrugor 50W F V shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm V. Pulsant per komandimin e ndricimit, 10A V. Ndricues plafon 15W, LED, IP65 F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 V. Ndricues LED 60x60 36W V. Ndricues hermetik 35W LED, 1,2m V. UPS 10kVA 3:3 me autonomi 10min V. Sensore levizje 360* tavanor"V. Rack 19"" 32U, I pajisur me rrota, aksesore montimi shina, dere xhami etj" V. Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6 "V. Priza rrjeti tip RJ-45, cat 6, FTP, Kompletuar me adaptor" V. Patch guide per sistemimin e kabujve "V. Switch 24P I menaxhueshem 10/100/1000Mbps 1U, me 2 porta SFP te kompletuara me modul fibre single/multi mode" "V. Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=1.5 m" V. Panel me 4 ventilator me termostat V. Suport 6 priza PDU 19" 1HE 16A"V. Panel zjarri I adresueshem me 2 zona I zgjerueshem deri ne 4 (Perfshire dhe Konfigurim, StartUP)" V. Detektor optik Tymi I adresueshem V. Fleshues poshte tavanit per detektoret e fshehur V. Baze normale e pajisur me izolatore "V. Baze normale e pajisur me izolatore me kontakt per lidjen e fleshuesit" "V. Buton per thirrje manuale me thyerje xhami dhe I pajisur me izolator" V. Bateri 12V 12Ah V. Sirene e jashtme optike-akustike</p>	
--	--	---	--

		<p>V. Bateri 12V 2,4Ah per sirenen e jashtme "V Sirene e brendshme optike-akustike e adresueshme ne LOOP" F.V. Kabell zjarri G4, S=2x1x1 mm² "V. Central GSM me mundesi minimumi 4 Inpute, dhe mundesi thirrje mbi 5numra"V. Rrufeprites ESE PREVECTRON 3 TS 25 F.V. Percjelles hekuri i zinkuar D8mm F.V. Percjelles shirit bakri tokezimi, Cu=30x3mm V. Tabele impiant tokezimi 250x150mm "F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m" "F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086" V. Morsete, shkeputes per matje tokezimi V. Morsete fiksime universale "V. Suport plastik +kubik betoni per shufer Zn, cdo 1m"</p>	
NS-18 A	Punime topogjeodezike	<p>"Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m³,shkarkimi ne auto" "Ndertim drenazhi,mbushje me zhavor prodhuar mak" Prishje struktura prej betoni "Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km" "Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne sheshe, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" "Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km"</p>	A 0-20 <i>(deri 20 milion leke</i>

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Kategoritë e licencave përcaktohen duke u bazuar në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton " 1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. 2. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit

dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane." Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne preventivin e hartuar nga projektuesi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| b. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| c. Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| d. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| e. Inxhinier gjeodet | 1 (një) |

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës individuale,të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë .
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi:AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. si dhe ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet

e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e këtyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin nr.42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar parashikohet se: "Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë."

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka përzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qene se këto punime janë të një rëndësie të veçantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në rindërtimin e një objekti në kuadër të procesit të rindërtimit dhe vlerësohet e nevojshme që të kërkojnë specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Elektrik, dhe Inxhinier Gjeodet.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP1, NP2, NS1, NS4, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierëve të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS2, është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Hidroteknik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS12, është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Mekanik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS14, është e nevojshme prezenca e një **Inxhinieri Elektrik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS18 është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet**.

Sa më sipër analiza teknike e këtyre të dhënave dhe kontrolli i nevojshëm në të gjithë etapat e punës që kërkohet të realizohet, kërkon minimalisht inxhinierët e kërkuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) Inxhinier ndërtimi që të disponojë certifikatën e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: Diplomë/certifikatë, Kontratë Pune të vlefshme.

Argumentimi: Kriteri është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësim të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këtë kontratë ku dhe numri i punonjësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
Punonjës Staf Teknik

a. Teknik Ndërtimi	1 (një)
b. Hidraulik	2 (dy)
c. Elektracist	2 (dy)
d. Karpentier	4 (katër)
e. Hekurkthyes	4 (katër)
f. Murator	4 (katër)
g. Pllakashtrues	4 (katër)
h. Hidroizolues	2 (dy)
i. Bojaxhi	4 (katër)
j. Punëtor ndërtimi të thjeshtë	10 (dhjetë)

Punonjës Manovrator

a. Shofer	2 (dy)
b. Automakinist /Manovrator	1 (një)

Për këta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës; një dokument (diplomë/dëshmi profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.

Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.)(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).

Për punonjësit Manovratorët duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet ne Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).

Për punëtorët e thjeshtë, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme.

Argumentimi: *Ky kriter mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.

Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport).

- **Teknik Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu organizimin dhe kontrollin e grupeve të angazhuara për të siguruar cilësinë e punimeve në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Hidrauliku:** Hidraulikët janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e sistemeve të kanalizimit të ujërave të ndotura, përfshirë montimin e tubacioneve, kontrollin e pompave, dhe sigurinë e rrjedhës së ujit tubacinet e godines dhe lidhjen sakte të nyjeve sanitare
- **Elektricitist:** Eshtë i nevojshëm për të kryer të gjitha punimet elektrike që janë parashikuar në projekt.
- **Karpiertierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave të preventivit. Bejne piktimin dhe armaturen anesore të themelit, bejne vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese për fazen e betonimit të mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera perforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Në rastin konkret duhen për ndërtimin e shtesës për kopshtin parashikuar në projekt
- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve edhe volumit të punimeve.
- **Hidroizolues** janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave të preventivit. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve.
- **Suvatues/murator** janë të nevojshëm për punimet e suvatimit dhe ndërtimin e murit të shtesës së parashikuar në projekt.
- **Pllakashtruesit** janë të nevojshëm për shtrimin e pllakave të tualeteve dhe veshjen
- **Bojaxhinjtë** janë të nevojshëm për punimet e lyerjes brenda dhe jashtë godines
- **Manovratori** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit si eskavator germimi dhe fadroma të të gjitha llojeve, të cilat janë kerkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive.
- **Shofer** nevojitet për manovrimin e automjeteve të transportit, kamion autobetoniere etj referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve
- **Punëtorët e thjeshtë** të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin të objekti.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 43 (dyzet e tre) persona, në listpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 43 punonjës përfshin punëtorë të thjeshtë , persona janë stafi i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë , person specializuar/të kualifikuar dhe person manovratorë/shoferë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur ne baze te volumeve te punës dhe grafikut te punimeve. Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerive/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre ne pune me kohështrirje muajin e fundit tregon besueshmëri për autoritetin qe, operatori do te përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore te operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit te kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, për sa kohe janë ne përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve ne regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhoje vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e te punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë ne përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri te caktuar, përveç besueshmërisë se operatoreve ekonomik, si një nga kërkesat themelore te kualifikimit, përpigjet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punës.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes 7.5 -18 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-5ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
Automjet me kapacitet mbajtës mbi 18 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
Vinc kulle	1 copë	Në pronësi ose me qira
Minieskavator me zinxhirë deri 3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
Mini Fadromë	1 copë	Në pronësi ose me qira
Autobot uji (kapaciteti minimal 5000 litra)	1 copë	Në pronësi ose me qira
Betoniere kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qira
Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qira
Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qira
Pompe Suvatimi	2 copë	Në pronësi ose me qira
Depozitë uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	1 copë	Në pronësi ose me qira
Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qira
Skeleri	2000m ²	Ne pronësi ose me qira

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; fotot përkatëse;

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve ne pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr.8402 date 10.09.1998 “për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, VKM nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr.631, datë 26.10.2018) “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN ISO 9001-2015 e përditësuar, e vlefshme/ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN ISO 14001-2015 e përditësuar, e vlefshme /ose ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatën SSH ISO 45001:2018 e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d. Certificate ISO 41001 -sistem i menaxhimit te objekteve, e vlefshme/ ose ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- e. Certificate ISO 55001 – Sistemi i Menaxhimit të Aseteve, e vlefshme/ ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të përthyera në gjuhën shqip. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jene të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 dhe nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë standarde të sigurimit të cilësisë dhe standarde të menaxhimit mjedisor, si dhe kritere të tjera të veçanta të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës, të nevojshme për realizimin me sukses të saj. Objekti i prokurimit “Ndërtim godina e njësisë administrative Katund i Ri (objekt i rindërtimit nga tërmeti)” paraqet rëndësi të veçantë publike, pasi lidhet me ndërtimin e një objekti institucional në kuadër të procesit të rindërtimit pas fatkeqësisë natyrore të tërmetit. Për shkak të natyrës së punimeve, rëndësisë së sigurisë strukturore, respektimit të standardeve teknike të ndërtimit, administrimit të proceseve të punës në kantier, mbrojtjes së mjedisit, si dhe garantimit të qëndrueshmërisë dhe mirëmenaxhimit të asetëve publike, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të provojnë se ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit dhe cilësisë.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë së punimeve të ndërtimit, organizimin e proceseve teknike dhe administrative, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe zbatimin korrekt të projektit gjatë gjithë fazave të ekzekutimit të kontratës. Kjo certifikatë garanton se operatori ekonomik disponon procedura të standardizuara për realizimin e punimeve në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente është e lidhur me ndikimin që aktiviteti i ndërtimit ka në mjedis, duke përfshirë administrimin e mbetjeve inerte, kontrollin e ndotjes, përdorimin e materialeve dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore gjatë realizimit të punimeve në kantier. Duke qenë se objekti realizohet në një zonë të banuar dhe në kuadër të programit të rindërtimit, mbrojtja e mjedisit dhe administrimi korrekt i mbetjeve të ndërtimit konsiderohen elementë të rëndësishëm të zbatimit të kontratës.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 45001:2018 ose ekuivalente lidhet me garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për personelin që do të angazhohet në realizimin e punimeve të ndërtimit.

Referuar natyrës së punimeve në objektet e rindërtimit, ku ekzistojnë procese me risk të shtuar teknik dhe fizik, autoriteti kontraktor vlerëson të domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë sisteme të menaxhimit të sigurisë në punë, me qëllim minimizimin e aksidenteve, mbrojtjen e punonjësve dhe respektimin e legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kërkesa për certifikatën ISO 41001 ose ekuivalente lidhet me nevojën për menaxhim të organizuar të objekteve dhe proceseve mbështetëse gjatë realizimit të kontratës, duke garantuar planifikim, koordinim dhe administrim eficient të ambienteve të punës, burimeve dhe proceseve operative në kantier. Duke qenë se objekti është një godinë administrative publike me funksion institucional, autoriteti kontraktor vlerëson se ky standard ndihmon në garantimin e praktikave të mira organizative dhe operacionale gjatë realizimit të punimeve.

Kërkesa për certifikatën ISO 55001 ose ekuivalente lidhet me nevojën për garantimin e menaxhimit eficient dhe të qëndrueshëm të aseteve publike gjatë ciklit të jetës së tyre. Duke qenë se objekti që do të ndërtohet është aset publik në funksion të administratës vendore dhe financohet në kuadër të programit të rindërtimit, autoriteti kontraktor vlerëson të rëndësishme që operatorët ekonomikë të disponojnë standarde organizative që lidhen me administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vlerës së aseteve infrastrukturore dhe ndërtimore.

Këto certifikata janë kërkuar në mënyrë proporcionale me natyrën dhe rëndësinë e objektit të prokurimit, lidhen drejtpërdrejt me kapacitetet organizative, teknike dhe menaxheriale të operatorëve ekonomikë dhe shërbejnë për të garantuar realizimin me cilësi, siguri dhe përgjegjshmëri të kontratës. Në respektim të legjislacionit të prokurimit publik pranohen edhe standarde ekuivalente.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/a dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e standardeve, cilësisë së materialeve, metodologjisë së zbatimit të punimeve dhe kërkesave teknike që duhet të përmbushen për realizimin e objektit “Ndërtim godina e njësisë administrative Ishëm (objekt i rindërtimit nga tërmeti)”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e projektit të zbatimit, kushteve teknike të ndërtimit, standardeve shqiptare dhe europiane në fuqi, si dhe referuar natyrës së veçantë të objektit, i cili realizohet në kuadër të programit të rindërtimit pas tërmetit. Këto specifikime përcaktojnë kërkesat minimale teknike për punimet e prishjes, gërmimet, themelet, strukturat betonarme, hidroizolimet,

rifiniturat, instalimet hidrosanitare, elektrike dhe sistemet e sigurisë, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë strukturore, sigurisë në përdorim, cilësisë së punimeve dhe jetëgjatësisë së objektit.

Gjithashtu, specifikimet teknike janë hartuar duke respektuar standardet e sigurisë në punë, mbrojtjes së mjedisit dhe aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, si dhe kërkesat për kontrollin e cilësisë së materialeve dhe testimeve gjatë zbatimit të punimeve.

Përcaktimi i këtyre specifikimeve teknike është bërë në mënyrë jo diskriminuese dhe proporcionale me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke synuar garantimin e realizimit të objektit sipas standardeve bashkëkohore të ndërtimit dhe funksionalitetit të një godine administrative publike.

Sipas specifikimeve teknike bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga projektuesi dhe ku janë mbështetur strukturat të posaçme të specializuara, grupi i ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, për hartimin e kërkesave për kualifikim lidhur me specifikimet teknike.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e prokurimit